



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2792/8 prot.

Datë 19.12.2023

V E N D I M
Nr. 1322/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.12.2023 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-82691-10-09-2023 me objekt “Blerje kimikate dhe reagente” me fond limit 3.653.525 (Tre milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre mijë e pesëqind e njezet e pese) leke pa TVSH, zhvilluar në datën 20.10.2023, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Qarku Shkodër SH.A.

Ankimues: Operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK me NIPT M11815028I dhe adresë Rruga e Kavajës, Buka SH.A, Nr.8240, Njësia Nr.6, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Qarku Shkodër SH.A me adresë Lagjja 3 Heronjtë, Rruga “Marin Biçikemi”, Shkodër.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të

Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 10-10-2023, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-82691-10-09-2023 me objekt “Blerje kimikate dhe reagente” me fond limit 3.653.525 (Tre milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre mijë e pesëqind e njezet e pese) leke pa TVSH, zhvilluar në datën 20.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Qarku Shkodër SH.A.

II.2. Në datën 20.10.2023 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 02.11.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

Albania Distribution Chemicals SHPK	3.094.575 lekë	skualifikuar
2 AT SHPK	3.170.230 lekë	kualifikuar
ATLANTIK 3 SHPK	Nuk ka paraqitur oferte ekonomike	

II.4. Operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit për arsyet si më poshtë:

*Bazuar ne proces-verbalin e vlersimit te ofertave, Komisioni Vleresimit te Ofertave per tenderin me objekt "Blerje kimikate dhe reagente" me nr. reference 82691-10-09-2023, i kerkoj shoqerise te klasifikuar e para ALBANIA DISTRIBUTION CHEMICALS dorezimin e dokumentacionit ne perputhje me nenin 26/6 te VKM nr. 285, date 19.05.2021. Shoqeria ALBANIA DISTRIBUTION CHEMICALS dorezoje dokumentacionin e kerkuar me inventarin qe mban nr. 1347 prot, date 01.11.2023. KVO- verifikoj dokumentacionin e paraqitur, duke e krahasuar me dokumentacionin e paraqitur ne menyre elektronike ne SPE, nga ku rezultoj mangesi ne kontraten huaperdorimi nr. repertori ***, koleksioni 1366, date 21.05.2022 e cila eshte deklaruar edhe ne Formularin e vetedeklarimit, per plotesimin e kriterit kualifikues te percaktuar ne DST, konkretisht: “2.2.7 Operatori ekonomik duhet te paraqese dokumente, qe vertetojne pronesine apo qiramarrjen per automjet te posaçem (AUTOBOT) 10.000-12.000 lt. per transportin e hipokloritit te natriumit ose me depozita 1000 lt te certifikuara te cilat te jene te testuara dhe te miratuara ne perputhje me dispozitat e ADR sipas Ligjit Nr. 118 / 2012 PER TRANSPORTIN E MALLRAVE TE RREZIKSHME pasi Hipokloriti i natriumit klasifikohet si produkt me ADR me kodin UN1791 , ADR 1791 SOLUCION HIPOKLORIT NATRIUMI dhe klasifikohet ne listen e lendeve vepruese per trajtimin e ujt te pijshem duke paraqitur certifikatat perkatese ADR per secilen prej tyre. Ne dokumentacionin bashkengjitur kontrates nr. repertori 2320, jane certifikata e pronesise se mjetit me targa AA***, leja a qarkullimit, certifikate e kontrollit teknik, police sigurimi, foto te mjetit, certifikata e miratimit per mjetet qe transportojne disa mallra te rrezikshme (ADR). Ky dokumentacion dhe me konkretisht certifikata ADR e mjetit verteton se kriteri kualifikues i percaktuar ne piken 2.2.7 (kriteret e veçanta te kualifikimit) te DST-ve nuk permbushet, per arsye si me poshte: Ne kriterin kaulifikues eshte kerkuar qe operatoret ekonomike te disponojne Autobot, ose depozita te certifikuara ne perputhje me dispozitat e ADR-se. Dokumentacioni i mjetit te paraqitur nuk eshte as autobot dhe as nuk ka cisterna te certifikuara nga dispozitat e ADR-se. Mjeti i paraqitur ka certifikaten e ADR-se, por ky mjet nuk eshte autobot, por mjet per transportim mallrash dhe ne certifikaten ADR-se nr. N2-Nd-0002274-004/1, pika 9 (pershkrimi i cisternes) nuk ka te percaktuar asnje cisterne. Mallrat qe kerkohet te transportohen jane klor i lengshem dhe mund te transportohen vetem ne dy menyra, Autobot ose cisterna te certifikuara. Dokumentacioni i paraqitur nuk permbush asnjeren nga keto kushte, pasi automjeti i paraqitur*

eshte mjet per transportim mallrash ne gjendje te ngurte, per transportimin e mallrave ne gjendje te lenget duhet te kene edhe depozita. Per sa me siper, "Shoqeria ALBANIA DISTRIBUTION CHEMICALS" nipt- M11815028I skualifikohet nga kjo procedure prokurimi, pasi nuk permbush kriterin kualifikues te DST-ve "2.2.7Operatori ekonomik duhet te paraqese dokumente, qe vertetojne pronesine apo qiramarrjen per automjet te posaçem (AUTOBOT) 10.000-12.000 lt. per transportin e hipokloritit te natriumit ose me depozita 1000 lt te certifikuara te cilat te jene te testuara dhe te miratuara ne perputhje me dispozitat e ADR sipas Ligjit Nr. 118 / 2012 PER TRANSPORTIN E MALLRAVE TE RREZIKSHME pasi Hipokloriti i natriumit klasifikohet si produkt me ADR me kodin UN1791, ADR 1791 SOLUCION HIPOKLORIT NATRIUMI dhe klasifikohet ne listen e lendeve vepruese per trajtimin e ujt te pijshem duke paraqitur certifikatat perkatese ADR per secilen prej tyre.

II.5. Në datën 08.11.2023, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE, Publikimin e Njoftimit të Fituesit Paraprak.

II.6. Në datën 12.11.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me nr. ankimi elektronik A/2023/3594, protokolluar me nr. protokoli 2792/2023, datë 13.11.2023, e operatorit ekonomik "Albania Distribution Chemicals" SHPK, ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike.

II.7. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 "Për prokurimin Publik" Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr.2792/2 prot., datë 13.11.2023 lidhur me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik "Albania Distribution Chemicals" SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. protokoli 2792 datë 12.11.2023.

II.8 Në përfundim të afatit brenda të cilit autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor të trajtimit të ankesës dhe daljes me një vendim përfundimtar në përputhje me nenin 114 të ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", Komisioni i Prokurimit Publik me anë të shkresës nr. 2792/3 prot., datë 04.12.2023, i ka kërkuar autoritetit kontraktor, Shoqeria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Qarku Shkodër SH.A, të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, si dhe të jepet informacion i hollësishëm, lidhur me trajtimin e ankesës të operatorit ekonomik "Albania Distribution Chemicals" SHPK.

II.9 Me anë të shkresës nr. 2792/4 prot., datë 14.12.2023, Komisioni i Prokurimit Publik i ka ridërguar kërkesë autoritetit kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Qarku Shkodër SH.A, që të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, si dhe të jepet informacion i hollësishëm, lidhur me trajtimin e ankesës të operatorit ekonomik "Albania Distribution Chemicals" SHPK.

II.10 Njëpërmjet shkresës me nr. 2328/1 prot., datë 13.12.2023, protokolluar me tonën me nr. 2792/5 prot., datë 18.12.2023, me lëndë “Informacion në lidhje me shkresën nr. 2792/3 prot. datë 04.12.2023”, është depozituar nga autoriteti kontraktor “Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër SH.A” informacion lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimes, ku konstatohet se e ka refuzuar si vijon:

“Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 2792/3 prot., datë 04.12.2023 të protokolluar nga ana jonë me nr. 2328 prot., datë 12.12.2023, në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals”, për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje kimikate dhe reagentë” me nr. reference 82691-10-09-2023 të zhvilluar nga autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër, ju informojmë si më poshtë:

Operatori ekonomik ofertues “Albania Distribution Chemicals” nuk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor në kundërshtim me përcaktimet e nenit 111 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 94 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”. Për këtë arsye ankesa e paraqitur vetëm në KPP nuk është marrë në shqyrtim nga autoriteti kontraktor[...]”

II.11. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të tjera të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimes, vlen të theksojmë se operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK ka paraqitur ankim në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit, si pranë autoritetit kontraktor ashtu dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike.

Sa më sipër, vlen të theksojmë, se në datën 27.10.2021, Komisioni i Prokurimit Publik ka implementuar sistemin e Regjistrimit Elektronik të Ankesave, duke mundësuar tashmë për të gjithë operatorët ekonomikë, paraqitjen e ankesës në të njëjtën kohë, pranë Komisionit të

Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në rrugë elektronike. Me dorëzimin e ankesës në sistemin elektronik, në përputhje me afatet në ligjin 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ankesa menjëherë konsiderohet e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, njëkohësisht në të dyja institucionet. Ankesa dhe e gjithë përmbajtja e saj është e aksesueshme nga autoriteti kontraktor, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Gjithashtu, me vendimin nr. 329, datë 06.04.2022, “Për miratimin e manualit të autoriteteve kontraktore për përdorimin e sistemit të ankesave elektronike dhe shqyrtimin e ankesave nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike”, Komisioni i Prokurimit Publik ka miratuar manualin për autoritetet kontraktore, për përdorimin e sistemit të ankesave elektronike dhe shqyrtimin e ankesave nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike.

KPP sqaron se, me paraqitjen e ankesës nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar formularin për publikim Nr.2792/2 prot., datë 13.11.2023, lidhur me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. protokollin 2792, datë 13.11.2023, gjithashtu në momentin e paraqitjes së ankesës në Sistemin e Ankesave Elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik ka njoftuar personin përgjegjës për prokurimet (në adresën e e-mailit të publikuar në dokumentet e tenderit) lidhur me paraqitjen e ankesës. Akoma më tej, me shkresën me nr. 2792/3 prot, datë 04.12.2023, dhe me shkresën me nr. 2792/4 prot, datë 14.12.2023, Komisioni i Prokurimit Publik me qëllim vijimin e gjyqimit të ankesës, në përputhje me nenin 114 të LPP-së, i ka kërkuar autoritetit kontraktor të dërgojë informacion lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK.

III.2 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” SHPK me arsyetimin se “[...]Automjeti që unë kam vënë në dispozicion është i pajisur nga Republika e Shqipërisë me Certifikimin ADR, për transport të lëndëve të rrezikshme ashtu sikurse ligji nr. 118/2012 Per transportin e mallrave të rrezikshme, me nenin 4, pika 7 e parashikon. Automjeti i pajisur me ADR do të transportojë depozitat të cilat do të jenë të pajisura etiketimin përkatës që përcaktohet në ligjin nr. 9272, datë 16.09.2004 Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen Europiane “Për transportin Ndërkombëtar Rrugor të Mallrave të Rrezikshme(ADR)” për protokollin e Nënshkrimit”, etiketimi përfshin numrin identifikues UN 1791 i cili është simboli tregues për kimikatin që gjendet brenda në IBC (Depozitat 1000 litra) pra që nënkupton se brenda depozitave transportohet malli hipoklorit natriumi.

Thënë kjo pretendimet e AK janë të pa baza pasi ne kemi dorëzuar dokumentacionin e automjetit ADR ashtu sikurse e kemi paraqitur ndërkohë depozitat do të importohen nga një vend i BE, Itali ë certifikuara, të testuara dhe të miratuara në përputhje me depozitat e ADR dhe me ligjin nr. 9272 datë 16.09.2004 Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen Europiane “Për transportin Ndërkombëtar Rrugor të Mallrave të Rrezikshme(ADR)” për protokollin e Nënshkrimit, në doganën Shqiptare, duke respektuar çdo element transporti të lëndëve të rrezikshme, sepse nëse nuk do të rezultonin të tilla ato nuk mund të kalonin procedurën e eksportit dhe importit, kjo pasi ligji i ADR është një kusht i vendosur nga vetë Bashkimi Europian”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1 Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.2.7 “Kapaciteti Teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.2.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumente, që vertetojnë pronesinë apo qiramarrjen për automjet të posaçëm (AUTOBOT) 10.000-12.000 lt. për transportin e hipokloritit të natriumit ose me depozita 1000 lt të certifikuar të cilat të jenë të testuara dhe të miratuara në përputhje me dispozitat e ADR sipas Ligjit Nr. 118 / 2012 PER TRANSPORTIN E MALLRAVE TE RREZIKSHME pasi Hipokloriti i natriumit klasifikohet si produkt me ADR me kodin UN1791 , ADR 1791 SOLUCION HIPOKLORIT NATRIUMI dhe klasifikohet në listën e lendeve vepruese për trajtimin e ujit të pijshëm duke paraqitur certifikatat përkatëse ADR për secilën prej tyre.

(Kërkesa 2.2.7 do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatit të ankimimit dokumentet e deklaruara si më lart).

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

III.2.2. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor nëpërmjet shkresës nr. 2328/1 prot., datë 13.12.2023, në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë huapërdorjeje nr. 2320 Rep., dhe 1366 Kol., datë 21.05.2022 të lidhur mes huadhënësit Shoqëria “E&B” SHPK dhe Huamarrësit Shoqëria “Albania Distribution Chem” për mjetin IVECO FIAT, të llojit kamion, me targa AA273LC ;
- Certifikatë e pronësisë së mjetit AA273LC në emër të “E&B” SHPK;
- Leje qarkullimi për mjetin nr. AA273LC;
- Certifikatë e kontrollit teknik të mjetit AA273LC;
- Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjetit AA273LC;
- Certifikatë e miratimit për mjetet që transportojnë disa mallra të rrezikshme për mjetin AA 273LC;
- Foto të mjetit;

III.2.3 Në pikën 1 të nenit 77 të LPP-së përcaktohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës... ”.

Në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

Në nenin 41 të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar përcaktohet se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.2.5 Në nenin 4, pika 2, të ligjit nr.118/2012 “Për transportin e mallrave të rrezikshme” parashikohet: “2. “ADR” janë anekset A dhe B të marrëveshjes europiane “Për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme”, të rishikuar ose të ribotuar, herë pas here, sipas pikës 1 të nenit 5 të këtij ligji.”

Ndërsa në nenin 4, pika 7, të ligjit nr.118/2012 “Për transportin e mallrave të rrezikshme” parashikohet: “7. “Certifikatë e miratimit të mjetit, sipas ADR-së” është certifikata e miratimit të mjetit, e lëshuar nga institucionet, sipas nenit 37 të këtij ligji, që vërteton se një mjet i vetëm i destinuar për transportin e disa mallrave të rrezikshme plotëson kërkesat teknike përkatëse, sipas marrëveshjes së përmendur në pikën 1 të nenit 5 të këtij ligji”

Në nenin 12, pika 1, të po këtij ligji parashikohet se: “1. Për transportin e mallrave të rrezikshme përdoret mjeti: a) që është i prodhuar dhe i pajisur në përputhje me dispozitat e ADR-së ose RID-it; b) për të cilin ka një certifikatë të vlefshme të miratimit, sipas ADR-së, për transportin e disa mallrave të rrezikshme, kur një gjë e tillë specifikohet në dispozitat e ADR-së ose RID-it; c) që është i pajisur me panele (pllakata) dhe është i shënuar në përputhje me dispozitat e ADR-së ose RID-it.”

III.2.6. Në nenin 2, pika 9, të Udhëzimit nr.15, datë 24.07.2007, të Ministrisë të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave,

autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, i ndryshuar parashikohet: “9. *Certifikatë: dokument që mbahet në mjet dhe që:*

a) *provon zotërimin e licencës për rastet e transporteve rrugore të brendshme dhe ndërkombëtare, që janë subjekt licencimi;*

b) *i jep një mjeti rrugor me motor, të drejtën e operimit në transportet rrugore të brendshme dhe ndërkombëtare, për rastet e transporteve të mallrave për llogari të vet;*

c) *dokument që i jep të drejtën një mjeti për transportin e udhëtarëve, për llogari të vet, brenda dhe jashtë vendit.”*

Në pikën 3 të nenit 6 të Udhëzimit nr.15, datë 24.07.2007 të Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, i ndryshuar parashikohet;

3. *Transporti i mallrave brenda vendit*

<i>Lloji i veprimtarisë</i>	<i>Dokumenti që lëshohet</i>	<i>Autoriteti kompetent</i>
<i>Transporti për të tretë dhe me qira</i>	<i>licencë</i>	<i>Bashkia/qarku,</i>
<i>Transporti për llogari të vet</i>	<i>certifikatë</i>	<i>Bashkia</i>
<i>Transporti i mallrave të rrezikshme</i>	<i>certifikatë</i>	<i>DPSHTRR</i>
<i>Transporti me mjete jashtë norme</i>	<i>licencë</i>	<i>DPSHTRR</i>

Po këtu, në nenin 38 “Transporti i mallrave të rrezikshme brenda vendit” parashikohet: “*Veprimtaria e transportit të mallrave të rrezikshme brenda vendit për llogari të vet ushtrohet kundrejt certifikatës së mallrave të rrezikshme. Kjo certifikatë lëshohet për çdo subjekt, fizik ose juridik, që kërkon të kryejë transport mallrash të rrezikshme brenda vendit. Subjekti paraqet:*

a) *Certifikatën e aprovuar për mjetet që transportojnë mallra të rrezikshme të caktuara (sipas ADR), e lëshuar nga DPSHTRR-ja;*

b) *Certifikatën e kontrollit të pajisjes së transportueshme për mallra të rrezikshme, lëshuar nga Instituti i Enëve Nën presion. Për rinovimin e certifikatës për transport mallrash të rrezikshme, kërkohen dokumentet sipas shkronjave “a” dhe “b”.”*

III.2.7. Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, pas shqyrtimit të dokumenteve të tenderit, konstatohet, se autoriteti kontraktor në pikën 2.2.7 të kapacitetit teknik, ka kërkuar që *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumente, që vertetojnë pronësinë apo qiramarrjen për automjet të posaçëm (AUTOBOT) 10.000-12.000 lt. për transportin e hipokloritit të natriumit ose me depozita 1000 lt të certifikuar të cilat të jene të testuara dhe të miratuara në përputhje me dispozitat e ADR sipas Ligjit Nr. 118/2012 PER TRANSPORTIN E MALLRAVE TE RREZIKSHME*

pasi Hipokloriti i natriumit klasifikohet si produkt me ADR me kodin UN1791, ADR 1791 SOLUCION HIPOKLORIT NATRIUMI dhe klasifikohet ne listen e lendeve vepruese per trajtimin e ujt te pijshem, duke paraqitur certifikatat perkatese ADR per secilen prej tyre.

III.2.8. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, në përmbushje të këtij kriteri, operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, ka paraqitur Certifikatën e miratimit për mjetet që transportojnë disa mallra të rrezikshme, për mjetin me targë AA 273 LC, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, e vlefshme deri më datë 06.07.2026, e cila sipas lex specialis për transportin e mallrave të rrezikshme, është certifikata e lëshuar për mjetin AA 273 LC.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm, KPP konstaton, se operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, ka paraqitur dokumentacionin me anë të të cilit provon, se disponon certifikatë për mjetin me targë AA 273LC, me anë të së cilës dëshmon, se mjete plotëson kushtet e përshkruara nga Marrëveshja Europiane, datë 13.12.2012 “Për transportin e Mallrave të Rrezikshme”, lëshuar nga organi kompetent i caktuar me ligj, siç kërkohet në dokumentet e tenderit dhe disponimi i së cilës është një detyrim ligjor në rastet e transportit të mallrave të rrezikshme, referuar kjo në nenin 38 të Udhëzimit nr.15, datë 24.07.2007 të Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, i ndryshuar, në të cilin parashikohet se: *“Veprimtaria e transportit të mallrave të rrezikshme brenda vendit për llogari të vet ushtrohet kundrejt certifikatës së mallrave të rrezikshme. Kjo certifikatë lëshohet për çdo subjekt, fizik ose juridik, që kërkon të kryejë transport mallrash të rrezikshme brenda vendit....”*. Akoma më tej, referuar kriterit 2.2.7 të përcaktuar në dokumentet e tenderit, Komisioni gjykon, se në këtë rast operatori ekonomik do të bëjë vetëm transportimin e hipokloritit të natriumit dhe se autoriteti kontraktor e ka lënë të hapur mundësinë që transportimi mund të bëhet me autobot 10.000-12.000 lt ose me depozita 1000 lt të certifikuara, të cilat të jenë të testuara dhe të miratuara në përputhje me dispozitat e ADR, pra rezulton se depozitat mund të jenë njëpërdorimshe ose shumëpërdorimshe.

Sa më sipër, gjykojmë, se operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, për automjetin për të cilin duhet të kryejë transportin e mallit, i cili sipas legjislacionit në fuqi futet tek mallrat e rrezikshme, ka paraqitur certifikatë për transportin e mallrave të rrezikshme, siç kërkohet në dokumentet e tenderit, të lëshuara nga organi kompetent i ngarkuar me ligj (DPSHTRR).

Akoma më tej, Komisioni gjykon, se referuar nenit 124, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, autoriteti ose enti kontraktor, ka detyrimin të ndjekë zbatimin e kontratës sipas kushteve në bazë të të cilave është nënshkruar, për të garantuar se ajo zbatohet në kohën, cilësinë dhe vlerën e përcaktuar, në përputhje me kushtet e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe me legjislacionin në fuqi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-82691-10-09-2023 me objekt “Blerje kimikate dhe reagente”, me fond limit 3.653.525 (Tre milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre mijë e pesëqind e njezet e pese) leke pa TVSH, zhvilluar në datën 20.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Qarku Shkodër SH.A.
 2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e OE “Albania Distribution Chemicals” SHPK.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vëre në dijëni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga OE “Albania Distribution Chemicals” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri

